

VENDIM
Nr. 881, datë 20.12.2006

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR FUNKSIONET DREJTUESE DHE
PËRCAKTIMIN E KATEGORISË SË PAGËS TË NËPUNËSVE ME GRADA
DIPLOMATIKE NË MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME.**

(Ndryshuar me VKM nr. 446, datë 13.7.2007; nr. 1002, datë 2.7.2008; nr. 444, datë 27.4.2009; nr. 611, datë 8.7.2010; nr. 557, datë 11.8.2011; nr. 180, datë 8.3.2017)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar dhe të nenit 45 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Nëpunësit e Ministrisë së Punëve të Jashtme, që gëzojnë të drejtën e gradës, të paguhën në bazë të gradës diplomatike/konsullore, e cila përcaktohet në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

1/1. Shfuqizuar.

1/2. Shfuqizuar.

2. Në funksionet drejtuese, të përcaktuara në strukturën e Ministrisë së Punëve të Jashtme, si rregull, emërohen:

a) “Përgjegjës sektori”, nëpunësit e shërbimit të jashtëm, me gradë diplomatike jo më të ulët se “Sekretar i dytë” apo të barazvlefshme me të;

b) “Drejtor drejtorie”, nëpunësit e shërbimit të jashtëm, me gradë diplomatike jo më të ulët se “Sekretar i parë” apo të barazvlefshme me të;

c) “Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme”, nëpunësit e shërbimit të jashtëm, me gradë diplomatike jo më të ulët se “Këshilltar” apo të barazvlefshme me të.

3. Nëpunësi i shërbimit të jashtëm, me gradë diplomatike:

a) “Sekretar i dytë”, në rastin kur emërohet “Përgjegjës sektori” të paguhet me pagën e përcaktuar për këtë pozicion në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) “Sekretar i parë”, në rastin kur emërohet “Drejtor drejtorie” të paguhet me pagën e përcaktuar për këtë pozicion në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

c) “Këshilltar”, në rastin kur emërohet “Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme” të paguhet me pagën e përcaktuar për këtë pozicion në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Në rastet kur në funksione drejtuese emërohen nëpunës të shërbimit të jashtëm, me gradë më të lartë se minimumi i përcaktuar për funksionin përkatës, sipas pikës 2 të këtij vendimi, të paguhën sipas gradës diplomatike/konsullore, që kanë.

5. *Elementët e pagës për secilën kategori të përcaktuar në lidhjen nr. 1, si dhe vlerat për secilin element, janë të njëjta me ato të miratuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë.*

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti

i vitit 2006, miratuar për Ministrinë e Punëve të Jashtme.

7. Vendimi nr.324, datë 21.5.2004 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve për funksionet drejtuese dhe për strukturën e nivelet e pagave në Ministrinë e Punëve të Jashtme”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA NR.1

(Ndryshuar me VKM nr. 446, datë 13.7.2007; nr. 1002, datë 2.7.2008; nr. 444, datë

27.4.2009; nr. 611, datë 8.7.2010; nr. 557, datë 11.8.2011; nr. 180, datë 8.3.2017)

GRADA DIPLOMATIKE	POZICIONI	KATEGORIA E PAGËS
Ambasador	Sekretar i Përgjithshëm	I-b
Ministër Fuqplotë Ministër Këshilltar Konsull i Përgjithshëm	Drejtor i Përgjithshëm	II-a
Këshilltar	Drejtor	II-b
Sekretar i parë Konsull	Përgjegjës sektori	III-a
Sekretar i dytë Zëvendëskonsull	Specialist	III-b
Sekretar i tretë Agjent Konsullor	Specialist	IV-a
Atashe	Specialist	IV-b

LIDHJA NR.2

(Shtuar me VKM nr. 1002, datë 2.7.2008)

POZICIONI	KUALIFIKIMI/GRADA/ TITULLI SHKENCOR	SHTESA (LEKË/MUAJ)
Sekretar i Përgjithshëm	Profesor	30 000
	Profesor i asociuar	25 000
Drejtor i Përgjithshëm, Drejtor.	Doktor i shkencave	20 000
	Doktor i shkencave	25 000
Përgjegjës sektori, Specialist	Studime të thelluara pasuniversitare/masteri nivelit të dytë, Studime specializuese afatgjata	10 000
	Studime të thelluara pasuniversitare/master i nivelit të dytë	20 000

Shënim. Vlerat 20 000 lekë, për diplomat “Master i nivelit të dytë/studime të thelluara pasuniversitare”, dhe 25 000 lekë, për gradën shkencore “Doktor i shkencave”, zbatohen për nëpunësit, që i kanë përfituar diplomat përkatëse në universitetet apo shkollat e arsimit të lartë në vendet e përcaktuara në listën, që i bashkëlidhet udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Financave dhe Departamentit të Administratës Publike.

(Shtuar me VKM nr. 557, datë 11.8.2011; shfuqizuar me VKM nr. 180, datë 8.3.2017)

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT UNIVERSITAR

(Shtuar me VKM nr. 611, datë 8.7.2010)

**VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT
UNIVERSITAR**

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Diplomë e Nivelit të Dytë (DND). Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (DIND). Të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë.	12 000 lekë
2	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë + Master i Nivelit të Parë (MNP)	11 000 lekë
3	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP). Të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë.	10 000 lekë